

VENDIM
Nr.686, datë 31.3.2008

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV KABLLOR LUSHNJË”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë” dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllot subjektin “TV kabllor Lushnjë” pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonte:
 - a) kapitali themeltar.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)